



USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 35 (827733)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 27 Gusht 2021

Baza Ajrore e NATO-s në Kuçovë



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Begaj, pret Kongresmenin Quigley

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, Gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, priti në një vizitë njohëse në bazën Ajrore të Kuçovës, Kongresmenin e SHBA, z. Michael Quigley, të shoqëruar nga stafi i tij dhe pjesëtarë civilë dhe ushtarakë të Ambasadës së SHBA-së në Shqipëri. Kongresmeni Quigley

u njoh nga afër me projektin e transformimit të bazës Ajrore të Kuçovës në një bazë taktike të NATO-s. Gjatë vizitës në bazë, Z. Quigley vlerësoi rolin dhe angazhimet e FARSH për paqen dhe sigurinë në rajon dhe më gjerë në kuadër të Aleancës. Gjeneralmajor Begaj nga ana e tij vlerësoi bashkëpunimin... >>> faqe 2

QENDRA E PERSONEL REKRUTIMIT

Akademitië Ushtarake të Turqisë kërkojnë 5 kandidatë për studime



>>> faqe 7

Kongresmeni amerikan Mike Quigley Ministri Peleshi: Angazhimi i Shqipërisë përkrah SHBA e aleancës së NATO-s është i padiskutueshëm

Baza e Kuçovës do të marrë një financim prej 58 milionë dollarësh nga NATO, për t'a modernizuar atë tërësisht, në mbështetje të transportit ajror, logjistikës, politikave ajrore dhe trajnimeve të NATO-s >>> faqe 3



Zjarret në vend

FA dhe helikopterët holandezë në terren për shuarjen e zjarreve

Në qarkun Kukësit, më 23 gusht 2021, në Majën e Rrunës, njësi administrative Malzi, bashkia Kukës, vijoi puna për shuarjen e zjarrit aktiv, i cili vijonte të mbetej ende problematik. Në vendngjarje kanë punuar 30 forca ushtarake, 10 forca zjarrfikëse. Në qarkun Shkodër, zjarri në fshatin Flet, njësi administrative Blerim, bashkia Fushë-Arrëz, ka qenë aktiv, por vatra ishte e qetë dhe pa rrezik për përhapje. Në fshatin...



>>> faqe 4

Emergjencat

Punohet për normalizimin e situatës nga FA, autoritetet lokale dhe vullnetarët

Më 21 gusht 2021, ende vazhdonte të kishte vatra zjarri aktive në disa zona të vendit. Në qarkun Lezhë, bashkia Mirditë, njësi administrative Fan, fshati Thirrë, vatra e zjarrit në drejtim të fshatit Xhuxh ishte nën kontroll. Në drejtim të fshatit Hebe, zjarri vazhdoi të jetë aktiv, me intensitet të ulët dhe momentalisht nuk pati rrezik për banesat. Por po monitorohej nga forcat në terren dhe nga... >>> faqe 5

Takimi i G7 mbi Afganistanin Stoltenberg: Të mbahet hapur aeroporti i Kabulit, parësor evakuimi i njerëzve

>>> faqe 10

ANALIZË

Mësime nga përvoja luftarake

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ faqe 8

ANALIZË

Raporti i zhdrejtë i fuqisë së "shpirtit" me "shpatën" në ushtrinë Afgane

KOLONEL HYSNI GJERGJI faqe 9



Baza Ajrore e NATO-s në Kuçovë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Begaj, pret Kongresmenin Quigley

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, priti në një vizitë njohëse në bazën Ajrore të Kuçovës, Kongresmenin e SHBA, z. Michael Quigley, të shoqëruar nga stafi i tij dhe pjesëtarë civilë dhe ushtarakë të Ambasadës së SHBA-së në Shqipëri.

Kongresmeni Quigley u njoh nga afër me projektin e transformimit të bazës Ajrore të Kuçovës në një bazë taktike të NATO-s. Gjatë vizitës në bazë, Z. Quigley vlerësoi rolin dhe angazhimet e FARSH për paqen dhe sigurinë në rajon dhe më gjerë në kuadër të Aleancës.

Gjeneralmajor Begaj nga ana e tij vlerësoi bashkëpunimin midis dy vendeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, duke veçuar asistencën e vyer të SHBA në modernizimin e FARSH e së fundmi, në implementimin e projektit të bazës ajrore. “Baza Ajrore e Kuçovës u identifikua si një pikë strategjike për



Aleancën edhe gjatë kryerjes së stërvitjes Defender-21, në të cilën SHBA shprehën mbështetjen për sigurinë e Ballkanit dhe Evropës në tërësi”, u

shpreh ndër të tjera gjeneral Begaj. Kongresmeni Quigley është anëtar i disa komiteteve të Kongresit të SHBA-së, ku mund të veçohet Komiteti i Për-



vetësimeve dhe Komiteti i Përherëshëm i Zgjedhur i Dhomës për Inteligjencën. Më herët, gjatë vizitës në Tiranë, Kongresmeni Quigley zhvilloi takim edhe

me Ministrin e Mbrojtjes, Z. Niko Peleshi ku u vlerësua partneriteti strategjik midis dy vendeve e në veçanti në fushën e mbrojtjes.

Rritje e ndërveprueshmërisë me Aleancën

Transformimi i bazës Ajrore të Kuçovës në bazë taktike të NATO-s

Baza Ajrore e Kuçovës, si një aset i Forcave tona të Armatosura sot është pranë ringritjes dhe në rrugën e shndërrimit të saj në një bazë të NATO-s. Ajo është gjithashtu baza e vetme e Aleancës në Ballkanin Perëndimor. NATO do të shpenzojë mbi 50 milionë euro në fazën e parë të punës për ta kthyer Kuçovën në një bazë mbështetëse për furnizime, logjistikë, trajnim dhe manovra. Baza Ajrore e Kuçovës ka një histori të vjetër për Forcat Ajrore shqiptare. Ajo ka filluar të përdoret si fushë aviacioni gjatë LIIB nga ushtria italiane dhe pas luftës nuk ka pasur aktivitet, deri në 5 maj të vitit 1955, datë e cila shënon inaugurimin, si baza e parë ajrore e Aviacionit Luftarak Shqiptar. Për 50 vjet ka qenë shkolla praktike e fluturimeve luftarake për të gjithë pilotët, teknikët, specialistët dhe inxhinierët e avionëve aktivë të diplomuar nga shkolla e aviacionit. Janë kryer mijëra orë fluturime ditën dhe natën. Regjimenti u krijua si formacion i parë i madh luftarak i Forcave Ajrore, për mbrojtjen e hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë. Bërthama e parë u krijua me vendim të posaçëm, ku u morën masa për përgatitjen e efektivit pilot e teknik për teknikën e re reaktive me të cilën do të pajisej reparti. Krahas këtyre u morën masa për përgatitjen e ambienteve për pritjen e efektivit dhe teknikës. Pas përfundimit të përgatitjes së efektivit pilot e inxhiniero-teknik, Regjimenti mori formën e plotë, i gatshëm për



kryerjen e detyrave. Në janar të vitit 1956 filloi përgatitja luftarake e organizuar mbi bazën e një planëzimi të rregullt. Në maj të këtij viti u krijua nënreparti i oficinës së mirëmbajtjes së avionit. Në korrik të vitit 1957 në këtë aerodrom u ul për herë të parë avioni bombardues JI- 28, i cili hyri në

armatimin e Aviacionit tonë Luftarak. Në dhjetor në Kuçovë ulet një avion transporti anglez Skymaster. Në muajin prill të vitit 1961, për herë të parë filloi eksperimentimi i karburantit të markës shqiptare i prodhuar nga punonjësit e laboratorit të naftës. Në vitin 1964 në vartësi të regjimentit u krijuan

dy reparte të reja, Batalioni i Shërbimit të Aerodromit dhe Grupi i Radio-Dritës. Në vitin 1965 krijohet skuadrilja e tretë reaktivo-mësimore për përgatitjen e pilotëve, teknikëve të rinj. Në fillim të vitit 1966 filluan punimet për ndërtimin e Uzinës së Riparimit të Avionëve,

ndërsa në muajin prill repartit pajiset me një skuadrilje MIG-17. Në gusht të vitit 1975 eksperimentohet për herë të parë qitje natën me raketa, ndërsa në vitin 1977 për herë të parë eksperimentohet bombardimi nga fluturimi horizontal në lartësi të vogël. Në vitin 1979, u vu në gatishmëri për drejtimin luftarak të regjimentit Vendkomanda e Kohës së Luftës. Në paradën ajrore me rastin e 35-vjetorit të çlirimit të Atdheut, repartit mori pjesë me 9 avionë. Në vitin 1984 repartit emërohet “Regjimenti 23 i Aviacionit Gjuajtës Bombardues”, ndërsa në vitin 1985 dekorohet me urdhërin “Për shërbime të shquara në fushën e mbrojtjes”. Në vitin 1995 krijohet Baza e Mbrojtjes Ajrore Kuçovë, viti 1999, është viti i kthimit në normalitet, ndërsa në vitin 2001, në strukturën e re organizative të Forcave Ajrore, ky repart kalon në Akademia e Forcave Ajrore, duke pasur në vartësi dhe Fakultetin Teoriko-Mësimor Vlorë. Në vitin 2003 vazhduan punimet nga pala turke në aerodromin e Kuçovës, të cilat përfunduan në kohë sipas planit. Në vitet në vazhdim si detyrë kryesore ka qenë modernizimi i infrastrukturës për plotësimin e standardeve dhe kushteve të aerodromit të Kuçovës si Host Nation Support. Baza e Kuçovës e ka kryer me sukses detyrën, sot në bazë zhvillohen fluturime bashkë me partnerët e NATO. Vendimi i Aleancës për ta kthyer në bazë taktike, shërben për të rritur shkallën e ndërveprueshmërisë me Aleancën.

Kongresmeni amerikan Mike Quigley

Ministri Peleshi: Angazhimi i Shqipërisë përkrah SHBA e aleancës së NATO-s është i padiskutueshëm

Baza e Kuçovës do të marrë një financim prej 58 milionë dollarësh nga NATO, për t'a modernizuar atë tërësisht, në mbështetje të transportit ajror, logjistikës, politikave ajrore dhe trajnimeve të NATO-s

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, priti në takim kongresmenin amerikan Mike Quigley në 19 gusht 2021. Kongresmenin Quigley shoqërohej nga ambasadorja amerikane në Shqipëri znj. Yuri Kim. Në takim me ministrin e Mbrojtjes Niko Peleshi të pranishmit diskutuan rreth marrëdhënieve të shkëlqyera mes Shqipërisë dhe SHBA, si dhe marrëdhënieve në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. “Nga takimi me kongresmenin amerikan Mike Quigley, me të cilin diskutuam për marrëdhëniet e shkëlqyera mes Shqipërisë dhe SHBA, sidomos në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.”, informoi ministri Peleshi “Angazhimi i Shqipërisë përkrah SHBA dhe aleancës së NATO është i padiskutueshëm”, shkroi ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi në profilin e tij zyrtar në rrjetin social, teksa publikoi fotot nga takimi.

Kongresmeni Mike Quigley përfaqëson distriktin e 5-të të Illinois. Gjatë vizitës së tij në Tiranë në datat 18 dhe 19 gusht ai u takua me ambasadorën Kim, ministrin e Mbrojtjes Niko Peleshi, shefin e Shtabit, gjeneralmajor Bajram Begaj dhe vizitoi bazën ajrore të Kuçovës. Baza e Kuçovës për modernizimin e saj do të marrë një financim prej 58 milionë dollarësh nga NATO. Ky financim ka parasysh modernizimin tërësisht të bazës, në mbështetje të transportit ajror, logjistikës, politikave ajrore dhe trajnimeve të NATO-s. Ndërkohë Ambasada e SHBA-së në Tiranë publikoi fotot nga takimi i ambasadores, Yuri Kim, e cila mirëpriti kongresmenin e Shteteve të Bashkuara Mike Quigley në datat 18 dhe 19 gusht. “Ambasadorja Kim mirëpriti



Kongresmenin e Shteteve të Bashkuara Mike Quigley në Shqipëri këtë javë. Kongresmeni përfaqëson distriktin e 5-të të Illinois dhe në datat 18 dhe 19 gusht ishte në Tiranë, ku u takua me Ambasadorën Kim, Ministrin e Mbrojtjes Niko Peleshi, Shefin e Shtabit Begaj dhe

vizitoi bazën ajrore të Kuçovës. Baza e Kuçovës do të marrë një financim prej 58 milionë dollarësh nga NATO, për t'a modernizuar atë tërësisht, në mbështetje të transportit ajror, logjistikës, politikave ajrore dhe trajnimeve të NATO-s.”, tha ambasada Amerikane në Tiranë.



SITUATA E ZJARREVE NË VEND

Operacioni për shuarjen e vatrave të zjarrit, në majën e Rrunës

E dhe pse në një situatë shumë të përmirësuar, Forcat e Armatosura dhe helikopterët holandezë vijojnë punën shuarjen e zjarreve në vend. Trupat tanë dhe helikopterët Chinook u angazhuan në 24 gusht 2021, në Majën e Rrunës në Kukës dhe fshatin Lundre në Burrel, ndërkohë që një operacion nisi gjithashtu nga toka nga FA dhe zjarrfikësit e Kavajës, Rrogozhinës dhe Tiranës në fshatin Mengël të Kavajës. Megjithatë, asnjë nga këto zjarre nuk paraqiti rrezik për zonat e banuara, ndërkohë që vatrat e tjera në vend ishin drejt shuarjes përfundimtare.

Situata e zjarreve në vend më 24 gusht 2021, u paraqit si më poshtë:

Në qarkun Kukës, në majën e Rrunës, njësi administrative Malzi, bashkia Kukës, krahas helikopterit holandez në terren janë edhe 30 trupa të Forcave të Armatosura. Situata u paraqit problematike në Majën e Zezë.

Në qarkun Shkodër zjarri në fshatin Flet, njësi administrative Blerim, bashkia Fushë - Arrëz, u mbajt nën kontroll, nuk paraqiti rrezik, zjarri në fshatin Srriqe, njësi administrative Qafë - Mali, bashkia Fushë - Arrëz, u mbajt nën kontroll gjithashtu nga zjarrfikësit lokale. Vazhdoi puna për shuarjen e vatrave të vogla të zjarrit në vendin e quajtur Qershizë - Fushë Kumulli në malin e Tërbunit, bashkia Pukë.

Në qarkun Vlorë zjarri në malin Çipin të fshatit Mesaplik, njësi admin-



istrative Brataj, bashkia Selenicë, u monitorua nga punonjës të njësisë administrative. Nuk pati rrezik për banesat.

Në qarkun Lezhë, në fshatin

Kodër - Thirrë, njësi administrative Fan, bashkia Mirditë, vijoi puna nga zjarrfikësit e bashkisë Mirditë në disa zona të caktuara për ta mbajtur zjarrin nën kontroll. Nuk paraqet

rrezik për zona të banuara. Zjarri në fshatin Domgjon dhe Munellë, njësi administrative Fan, bashkia Mirditë ka intensitet të ulët dhe nuk paraqet rrezik për përhapje edhe në zona të banuara.

Vatra u mbajt në monitorim. Zjarri në fshatin Katund i Vjetër, Malung, njësi administrative Rubik, bashkia Mirditë nuk paraqiti rrezik për zonën e banuar dhe u mbajt në monitorim.

Në qarkun Dibër, në fshatin Lundre, njësi administrative Ulëz, bashkia Mat, gjatë mbrëmjes së djeshme zjarri u përhap për shkak të erës. kurse në datën 24 gusht punoi helikopteri holandez, zjarrfikësit e bashkisë dhe punonjësit e shërbimit pyjor. Zjarri nuk paraqiti rrezik për banesat. Në fshatin Kacni (në pjesën fundore të tij në fshatin Balgjaj 1 që kufizohet me Klosin), njësi administrative Selishtë, bashkia Dibër, vijonte djegia e brendshme e vatrave, zjarri u monitorua nga forcat e bashkisë Dibër.

Në qarkun Tiranë zjarri në fshatin Mengël, njësi administrative Helmës, bashkia Kavajë nuk paraqiti rrezik për zona të banuara, megjithatë në terren krahas 40 trupave të FA-së, u angazhuan edhe zjarrfikësit e Kavajës, Rrogozhinës dhe Tiranës.

Zjarret në vend

FA dhe helikopterët holandezë në terren për shuarjen e zjarreve

Në qarkun Kukësit, më 23 gusht 2021, në Majën e Rrunës, njësi administrative Malzi, bashkia Kukës, vijoi puna për shuarjen e zjarrit aktiv, i cili vijonte të mbetej ende problematik. Në vendngjarje kanë punuar 30 forca ushtarake, 10 forca zjarrfikëse.

Në qarkun Shkodër, zjarri në fshatin Flet, njësi administrative Blerim, bashkia Fushë-Arrëz, ka qenë aktiv, por vatra ishte e qetë dhe pa rrezik për përhapje. Në fshatin Srriqe, njësi administrative Qafë-mali, bashkia Fushë-Arrëz, vijoi puna për shuarjen e vatrës aktive.

Zjarri në fshatin Armiraj, njësi administrative Qafë-Mali, bashkia Fushë-Arrëz vijoi të ishte aktiv edhe në datën 23 gusht.

Në qarkun Vlorë, zjarri në Malin Çipin të fshatit Mesaplik, njësi administrative Brataj, bashkia Selenicë vijoi gjithashtu të jetë aktiv. Por nuk pati rrezik për zonën e banuar.

Në qarkun Lezhë zjarri në fshatin Kodër Thirrë, njësi administrative Fan, bashkia Mirditë vijoi të ishte aktiv. Deri në datën 23 ishte është djegur rreth 230 ha sipërfaqe me barishte, pyll dukshku dhe lisi. Zjarri në fshatin Domgjon dhe Munellë, njësi administrative Fan, bashkia Mirditë gjithashtu ishte aktiv.

Në fshatin Katund i Vjetër, Malung, njësi administrative Rubik, bashkia Mirditë, ka vijuar gjatë gjithë ditës



puna për shuarjen e zjarrit të rënë në një sipërfaqe me shkurre të dendura dhe pyll.

Në qarkun Dibër zjarri në fshatin Lundre, njësi administrative Ulëz, bashkia Mat pas një pune të kryer nga helikopteri dhe nga forcat në terren ishte drejt shuarjes. Nuk pati rrezik për

zonën e banuar. MZSH Dibër së bashku me 6 forca nga shërbimi pyjor punuan për mbajtjen nën kontroll të zjarrit dhe shuarjen e tij.

Në qarkun Fier, më datë 23.08.2021, ora 15:00, në fshatin Mollaj, Njësia Administrative Hekal, bashkia Mallakastër,

ka rënë zjarr në një sipërfaqe me shkurre, ullishte dhe pisha. Shërbimi vendor i MZSH Mallakastër ndërkohë shkoi në vendngjarje dhe punoi për shuarjen e zjarrit. Nga informacioni paraprak zjarri njoftohet se u vu nën kontroll.

Në qarkun Tiranë, më datë

23.08.2021, ora 12:05, në fshatin Mengaj, Njësia Administrative Helmës, bashkia Kavajë, ka rënë zjarr në një sipërfaqe me shkurre dhe pisha. Shërbimi vendor i MZSH Kavajë ka shkuar në vendngjarje dhe punoi për shuarjen e zjarrit gjithashtu.

NËN MONITORIM SITUATA E ZJARREVE

Terreni i vështirë për ndërhyrje nga toka, helikopteri holandez operon nga ajri

Më 22 gusht 2021, ora 14:15, u njoftua se në qarkun Shkodër, bashkia Malësi e Madhe, vijonte vatra e zjarrit në fshatin Vorfë, njësi administrative Gruemirë. Zjarri është larguar në drejtim të malit Maranajt në një sipërfaqe pylli me shkurre. Terreni është shumë i thyer dhe i vështirë për ndërhyrje nga toka dhe në një distancë rreth 4 orë në këmbë. Për te vatra e zjarrit janë nisur vrojtues nga Shërbimi Pyjor. Rreziku nga stanet është larguar nga ndërhyrja e banorëve të zonës. Situata po monitorohet.

Në bashkinë Pukë, në vatrën e zjarrit në Qershizë, Fushë Kumulli, punuan rreth 50 trupa nga FA, zjarrfikës dhe punonjës të shërbimit pyjor. Situata gjithashtu u mbajt nën kontroll.

Në bashkinë Fushë Arrëz, në vatrën e zjarrit në fshatin Flet situata u paraqit e qetë, perimetri i zonës së djegur po monitorohej dhe mbahej nën kontroll nga punonjësit e njësive administrative Blerim dhe shërbimit pyjor.

Në fshatin Srriqe, njësi administrative Qafë - Mali, zjarri u vu nën kontroll nga helikopteri holandez dhe nuk pati problem për banesat. Vatra po monitorohej nga zjarrfikësit lokalë.

Në qarkun Kukës, në majën e Rru-



nës, në vendin e quajtur "Laku i Thive" njësi administrative Malzi, vatra e zjarrit vazhdonte të ishte problematike në Majën e Zezë. Në terren punuan rreth 50 trupa nga FA, zjarrfikësit dhe punonjësit e shërbimit pyjor. Në mbështetje të operacionit ka ndërhyrë edhe një helikopter holandez. Situata u paraqit problematike, pasi nga territori i bashkisë Pukë drejt Majës së Zezë u përhap një vatër tjetër zjarri.

Në fshatin Morinë, zona Korab - Koritnik zjarri u izolua plotësisht. Por po mbahej nën monitorim nga punonjësit të AdZM Kukës

Në qarkun Lezhë, vatra e zjarrit në fshatin Katund i Vjetër, njësi administrative Rubik, bashkia Mirditë ishte nën kontroll gjithashtu dhe po monitorohej nga specialistë të pyjeve dhe banorët.

Vatra e zjarrit në lagjen Sage, fshati Thirrë, njësi administrative Fan, bashkia Mirditë nën kontroll dhe pa rrezik për banesat. Me terren punuan edhe forcat zjarrfikëse.

Në qarkun Dibër, vatra e zjarrit në fshatin Kaçni, njësi administrative Selishtë u izolua plotësisht, zjarri vazhdonte djegie të ngadaltë brenda perimetrit të përshkuar. U monitorua nga punonjësit të njësive administrative.

Situata e zjarreve në vend

Punohet për normalizimin e situatës nga FA, autoritetet lokale dhe vullnetarët

Më 21 gusht 2021, ende vazhdonte të kishte vatra zjarri aktive në disa zona të vendit.

Në qarkun Lezhë, bashkia Mirditë, njësi administrative Fan, fshati Thirrë, vatra e zjarrit në drejtim të fshatit Xhuxh ishte nën kontroll. Në drejtim të fshatit Hebe, zjarri vazhdoi të jetë aktiv, me intensitet të ulët dhe momentalisht nuk pati rrezik për banesat. Por po monitorohej nga forcat në terren dhe nga autoritetet lokale.

Në bashkinë Mirditë, njësi administrative Rubik, fshati Katund i Vjetër, vatra e zjarrit ishte me intensitet të ulët. Vijoi puna për normalizimin e situatës nga FA, autoritetet lokale dhe vullnetarët.

Në bashkinë Mirditë, njësi administrative Fan, fshatrat Munellë dhe Domgjon: vatra e zjarrit ishte aktive me intensitet të ulët dhe djegie sipërfaqësore në malin Munellë. Vatra po monitorohej nga autoritetet lokale.

Në qarkun Shkodër, bashkia Pukë, Fushë Kumulli, Qershizë, vatra e zjarrit vazhdon aktive. Në terren janë angazhuar FA, zjarrfikësit lokalë dhe punonjësit e shërbimit pyjor.

Në bashkinë Fushë-Arrëz, njësi administrative Blerim, fshati Flet, vatra e zjarrit vazhdoi me intensitet të ulët dhe i gjithë perimetri i tij u vu nën kontroll. Në terren janë angazhuar autoritetet lokale për mbajtjen nën kontroll të vatrës dhe shuarjen e saj.

Në bashkinë Shkodër, njësi administrative Gur i Zi, fshati Gur i zi, vatra është izoluar dhe po mbahej në monitorim nga forca të pushtetit vendor.



Në bashkinë Fushë-Arrëz, njësi administrative Qafë-Mali, fshati Srriqë, zjarri iu është afruar shtëpive në fshatin Armiraj. Nga ajri operoi helikopteri

holandez, ndërsa nga toka punonin Forcat e Armatosura, zjarrfikësit e bashkisë dhe punonjësit e njësisë administrative dhe shërbimit pyjor.

Në qarkun Kukës, bashkia Kukës, Maja e Rrunës, vazhdonte vatra me intensitet mesatar. Terreni i thyer malor vështirësonte ndërhyrjen nga

toka, megjithatë FA, zjarrfikësit dhe punonjësit e pushtetit vendor vazhduan punën për izolimin e flakëve.

Në bashkinë Kukës, në vendin e quajtur stanet e fshatit Morin, në afërsi të malit Koritnik, brenda parkut natyror Korab-Koritnik, zonë e mbrojtur, zjarri u vu nën kontroll dhe po mbahej në monitorim nga shërbimi pyjor.

Në qarkun Elbasan, bashkia Elbasan, zjarri në fshatin Mamel, njësi administrative Gracen, mbi tunelin e Qafë Krrabës u shua. Në qarkun Dibër, bashkia Dibër, njësi administrative Selishtë, Qafë Murrë, Kaçni, zjarri u izolua dhe po digjeshin trungje e lëndë druri me intensitet të ulët brenda vatrës së zjarrit. U mbajtën nën monitorim vtratrat e zjarrit në Kaçni dhe Qafë - Murrë nga punonjësit e njësisë administrative Selishtë.

Në qarkun Vlorë, bashkia Himarë, vatra e zjarrit në vendin e quajtur "Përroi i Vishnjës", vazhdonte të ishte aktive. Zjarri nuk patui zhvillim të mëtejshëm por u dogën vetëm trungje dhe humus brenda vatrës. Terreni atje është i vështirë dhe nuk mundëson ndërhyrjen me forca.

Nën kontroll të plotë vatrata e zjarrit, pa rrezik për zonat e banuara

Roli i pushtetit vendor mbetet thelbësor

Zjarret vijojnë të mbeten aktive në vend, por të gjitha janë nën kontroll të plotë dhe pa rrezik për zonat e banuara. "Veç ndërhyrjes nga ajri, Forcat e Armatosura dhe ato të sistemit të mbrojtjes civile vijojnë punën në terren për eliminimin e plotë të vatrave. Megjithatë, roli i pushtetit vendor në informimin dhe reagimin në kohë mbetet thelbësor."

Në qarkun Lezhë, më 20 gusht 2021, ora 09:30, bashkia Mirditë, njësi administrative Fan, fshati Thirrë, vatra e zjarrit ka avancuar poshtë shpatit me intensitet të ulët në drejtim të fshatit Xhuxhë. Forcat në terren kanë vështirësi për shkak të tymit të dendur. Nuk ka rrezik për banesat. Për shuarjen e zjarrit veç helikopterit holandez Chinook janë angazhuar trupat e FA dhe autoritetet lokale.

Në bashkinë Mirditë, njësi administrative Rubik, fshati Katund i Vjetër, situata është më e qetë sot. Ka vijuar puna për normalizimin e situatës me helikopterin Cougar të Forcës sonë Ajrore, nga 25 efektivë të FA dhe autoritetet lokale.

Në bashkinë Mirditë, njësi administrative Fan, fshatrat Munellë dhe Domgjon, aktualisht vatra nuk paraqet rrezik dhe po monitorohej në terren. Zjarri vijon në një zonë të zhveshur pa bimësi.

Në bashkinë Lezhë, njësi administrative Kolsh, fshati Patalej, vatra e



zjarrit është izoluar dhe në disa pika të saj ka tym. Situata po mbahet në monitorim nga forcat e pushtetit vendor.

Në qarkun Shkodër, bashkia Pukë, Fushë Kumulli, Qershizë, situata është nën kontroll dhe paraqitet e qetë, por në terren

mbeten të angazhuar 25 trupa të FA-së, 8 nga shërbimi pyjor dhe 8 zjarrfikës.

Në bashkinë Fushë-Arrëz, njësi administrative Blerim, fshati Flet, situata sot paraqitet më e qetë. Në terren po punohet nga 20 trupa të FA-së dhe 52 forca

të bashkisë dhe shërbimit pyjor. Nga ana e fshatit Srriqë situata është pak më problematike, ku është planifikuar të ndërhyhet nga ajri.

Në bashkinë Shkodër, njësi administrative Gur i Zi, fshati Gur i Zi,

situata sot paraqitet e qetë, megjithatë vijon puna në terren nga FA dhe shërbimi pyjor lokal.

Në qarkun Kukës, bashkia Kukës, Maja e Rrunës, sot situata paraqitet më e qetë, megjithatë krahas ndërhyrjes së helikopterit holandez Chinook, vijon puna në terren nga FA, zjarrfikësit lokalë dhe punonjësit e njësisë administrative.

Në bashkinë Kukës, në vendin e quajtur stanet e fshatit Morin, në afërsi të malit Koritnik, brenda Parkut Natyror Korab - Koritnik zonë e mbrojtur, vijon të jetë aktive vatra, sot janë angazhuar 5 punonjësit të AdZM Kukës dhe 10 forca të njësisë administrative Tërthorë. Në qarkun Dibër, bashkia Dibër, njësi administrative Selishtë, Qafë Murrë, Kaçni, pasditen e djeshme ka pasur një riaktivizim të vatrës dhe sot janë angazhuar zjarrfikësit e Dibërës, punonjësit e shërbimit pyjor dhe 10 vullnetarë. Nga ana tjetër në Baxhaj po punojnë punonjësit e bashkisë Klos, por nuk ka rrezik për zonat e banuara.

Në qarkun Vlorë, bashkia Himarë, vijon aktive vatra në përroin e Vishnjës. Gjatë natës zjarri nuk ka avancuar. Aktualisht digjen vetëm trungje brenda vatrës si dhe humusi. Terreni është i vështirë dhe nuk lejon ndërhyrjen nga toka. Sipërfaqja është me shqipë dhe koçimare. Situata po monitorohej nga zjarrfikësit lokalë.

ANGAZHIMI I EFEKTIVËVE TË FORCËS TOKËSORE NË SHUARJEN E ZJARREVE

Rreth 140 trupa të pajisura me bazë materiale të dedikuar për shuarje zjarresh

Në disa zona të vendit tonë vazhdojnë të jenë aktive vatra zjarri, kryesisht në Fletë - Dardhë të Fushë - Arrëzit, Thirrë të Mirditës, mali i Tërbunit, Pukë, Katund i Vjetër, Rubik, si dhe Rragam, njësia administrative Gur i Zi, Shkodër.

Repartet e Forcës Tokësore vazhdojnë të jenë të angazhuara maksimalisht në operacionin për shuarjen e zjarreve, ku në operacion janë përfshirë rreth 140 trupa të pajisura me bazë materiale të dedikuar për shuarje zjarresh si dhe mbi 20 mjete me kalueshmëri të lartë.

Repartet e Forcës Tokësore do vijojnë të jenë të angazhuara deri në përmirësimin dhe shuarjen e të gjitha vatrave të zjarrit në vend.



Operacionet nga ajri

Misionet e ndërhyrjeve nga ajri për shuarjen e zjarreve në veri të vendit

Helikopteri Cougar, pilotët e teknikët e Forcës Ajrore në luftë me flakët



P prej dy ditësh, helikopteri Cougar dhe pilotët e teknikët e Forcës Ajrore po kryejnë misione të vështira të ndërhyrjeve nga ajri për shuarjen e shumë vatrave të zjarrit në zonën veriore të vendit.

Paraditen e dates 18 gusht, Cougar-i ka kryer operacione për shuarjen e zjarreve në Katundin e Vjetër në Rubik të Mirditës, në kushtet e kufizimit të shikimit për shkak të tymrave të shumtë mbi zonën e zjarreve.

Operacionet për shuarjen e zjarreve kanë vazhduar edhe sot në zonën e Fushë - Arrëzit, kryesisht në pyjet pranë fshatit Flet, duke minimizuar ndjeshëm zjarret, të cilat favorizohen shumë nga era.

Në operacionin për shuarjen e zjarreve në veri të vendit në zonën e Thirrës, Kukës ka kryer misionin edhe helikopteri Chinook holandez.

Gjatë këtyre dy ditëve, helikopteri Cougar i Forcës Ajrore dhe helikopteri Chinook holandez kanë hedhur së bashku qindra mijëra litra ujë duke ndikuar pozitivisht për zvogëlimin e pasojave të zjarreve në këtë rajon.

Vijojnë intesivisht operacionet nga ajri për shuarjen e zjarreve në veri të vendit

Helikopteri Cougar me ekipazhet e pilotëve dhe teknikëve në bord ka kryer misionet e ndërhyrjes nga ajri për shuarjen e zjarreve në veri të vendit. Operacionet nga ajri gjatë paradites janë kryer në fshatin Fletë, Fushë-Arrëz duke bërë të mundur eliminimin e vatrave të zjarrit në pyjet e këtij rajoni.

Pasdite helikopteri Cougar ka fluturuar drejt Shkodrës në fshatin Postribë në rajonin e Gurit të Zi,



operacion ky për shuarjen e zjarreve, i cili ka zgjatur deri në orët e vona të kësaj fillim jave. Në këto ndërhyrje nga ajri nëpërmjet kovës speciale "bambi bucket", helikopteri Cougar ka hedhur rreth njëqind mijë litra ujë në këto zona operimi.

Edhe në ditën e sotme, helikopteri holandez "Chinook" ka operuar për shuarjen e zjarreve në Thirrë, Kalimash dhe malin e Tërbunit në zonën e Pukës ndërsa helikopteri çek ka operuar në Patalej, Lezhë.

Qendra e Personel Rekrutimit

Akademitë Ushtarake të Turqisë
kërkojnë 5 kandidatë për studime*Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit deri në 14 shtator 2021*

Qendra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për studime në Akademitë Ushtarake të Turqisë, 5 (pesë) të drejta studimi si më poshtë vijon:

Akademia Ushtarake e Forcës Tokësore, 1 (një) kuotë. Akademia Ushtarake e Forcës Detare, 1 (një) kuotë. Akademia Ushtarake e Forcës Ajrore, 1 (një) kuotë. Fakulteti i Mjekësisë "GATA", 2 (dy) kuota. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri në 14 shtator 2021.

Kriteret e pranimit të kandidatëve:

Të jetë shtetas shqiptar. Të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale. Të mos jetë në ndjekje penale. Të mos jetë në proces gjykim penal nga gjykata. Të mos ketë probleme me deportimin. Të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike dhe alkoolit, për të cilat do të paraqesin testet e kryera. Të mos jetë person i dyshuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundërligjshme apo kriminale. Të jetë në moshë jo më pak se 18 vjeç dhe jo më shumë se 20 vjeç, në ditën e fillimit të vitit akademik. Të ketë kryer arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë. Kandidatët që do të aplikojnë për ndjekjen e studimeve pranë Akademive Ushtarake në Turqi të plotësojnë kriterin e notës mesatare të shkollës parauniversitare mbi 8 (tetë), mesatarja e notave të të gjitha viteve të gjimnazit për lëndët Matematik, Fizik dhe Kimi të jetë mbi 8 (tetë) dhe notat e maturës shtetërore të jenë mbi 8 (tetë). Të mos jetë i martuar, i fejuar, i ve ose të mos bashkëjetojë. Të jetë i aftë nga ana shëndetësore. Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm nga të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformojnë pamjen, të mos ketë tatuazhe ne pjesët e trupit, të mos jetë dyz taban, të mos ketë në trup plagë apo shenja djegie, të jetë me flokë dhe të mos ketë sëmundje të lëkurës, si dhe të ketë bërë të gjitha vaksinat dhe të mos jetë mbartës i sëmundjeve ngjitëse. Të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 165 cm për meshkujt dhe jo më pak se 160 për femrat. Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme) të tjera; të mos ketë kaluar apo të vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepatike, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe



lëvizjes) apo të ketë qenë ose jetë përdorues i lëndëve narkotike. Të rezultojë kalues në testet fizike, shëndetësore, intelektuale, gjuhësore ose trajnuese, që zhvillohen nga vendet partnere në vendin tonë ose pranë shkollave ushtarake jashtë vendit, me qëllim pranimin në shkolla ushtarake. Të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurimit. Të plotësojë kushtin e sigurisë. Të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor në Njësinë Mjekësore Ushtarake.

Kandidatët nuk mund të regjistrohen për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit, në rast se: a. Kanë kryer më parë të njëjtin nivel arsimor ushtarak brenda ose jashtë vendit. b. Kanë qenë kontingjent i Forcave të Armatosura për ndjekjen e studimeve ushtarake brenda dhe jashtë vendit dhe nuk i kanë përfunduar ato. Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përmendura më sipër, s'kualifikohet.

Dokumentet për regjistrim:

Kandidatët për regjistrim duhet të paraqesin pranë Zyrës së Pranimit Tiranë dokumentacionin e mëposhtëm:

Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati për ndjekjen e studimeve në Akademitë Ushtarake të Turqisë dhe

Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit përkatës së bashku



preferenca e degës për të cilën aplikohet. Formular me të dhënat personale sipas formatit të përcaktuar, Aneksi A

me certifikatën dhe listën e notave. Fotokopje e kartës së identitetit. Fotografi për dokument (4x6), 2 (dy) copë. Fotokopje të pasaportës e vlefshme për jashtë shtetit. Raport mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore të vendbanimit ishoqëruar edhe me një raport shpjegues, ku deklarohet se kandidati është i shëndetshëm, nuk ka sëmundje kronike, infektive, të shëndetit mendor + në anamnezën e tij personale dhe nuk është përdorues i lëndëve narkotike. Ekzaminimi

met mjekësore për agentë infektiv (Hepatit B, Hepatit C, Hepatit D, HIV/AIDS, Sifiliz), grupin e gjakut dhe lëndët narkotike, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe/ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në prefekturat apo rrethet ku banojnë, si dhe testet për lëndët narkotike nga laboratorë të certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Formularët e vetëdeklarimit, të cilët plotësohen pranë Qendrës së Personel Rekrutimit në momentin e dorëzimit të dokumentacionit. Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët e kualifikuar pas përfundimit të testimit, brenda 10 ditëve: Dëshmi penaliteti. Vërtetim nga gjykata. Vërtetim nga prokuroria. Vërtetim nga përmbartimi. Ekzaminimet për agentët infektivë (Hepatit B, Hepatit C, Hepatit D, HIV/AIDS, Sifiliz) dhe raportin mjekësor të lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor, në Njësinë Mjekësore Ushtarake. Testet për lëndët narkotike të lëshuar nga laboratorë të certifikuar nga Ministria e

Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Datat e testimit:

Testi i Gjuhës së Huaj (anglisht): 15.09.2021 Testi Fizik: 15.09.2021 Testi Intelektual: 16.09.2021 Testi Psikologjik: 16.09.2021 Kandidatët e përzgjedhur do të nënshtrohen edhe një testi intelektual (vlerësimi të nivelit të njohurive shkencore), që do të zhvillohet nga Zyra e Atashhut Ushtarak të Turqisë, i cili është s'kualifikues.



Mësime nga përvoja luftarake



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Shembull heroizmi dhe vetëmohimi ndaj popullit e atdheut

Rruga e Br. I S, ashtu si e çdo reparti e njësie të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare, është një rrugë e mbushur me vepra heroizmi, vetëmohimi dhe besnikërie të pakufishme ndaj popullit dhe atdheut. Në aktivin e saj luftarak numërohen më se 200 luftime, një pjesë e mirë e të cilave përmenden si betejat më të shënuara të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Të tilla janë lufta e Vithkuqit (gusht 1943), goditja e Xhyrës (shtator 1943), aksioni i Dervenit (tetor 1943), luftimet në Mallakastër (nëntor 1943), luftimet në Mesaplik (dhjetor 1943), luftimet në Dëshnicë e sidomos në Tendën e Qypit (janar 1944), marshimi i tri batalioneve në Veri (shkurt-mars 1944), luftimet në Tomoricë dhe lufta e Dunicës (shkurt-mars 1944), lufta e Pogradecit dhe luftimet në Mokër (prill 1944), luftimet gjatë Operacionit armik të Qershorit në Verçë, Shpat, Sulovë, te Ura e Moglicës, në Qafën e Gjarprit dhe në Qafën e Gurit të Prerë, në Shëmbërdhenj e në qafën e Dardhës (maj-qershor 1944), luftimet gjatë mësymjes së Div. I S në Veri, sidomos luftimet në Çerenec, në Gollobordë, në Peshkopi dhe në Dibër (korrik-gusht 1944), luftimet për çlirimin e plotë dhe për mbrojtjen e Matit (gusht 1944), lufta e Krujës dhe sulmi në Prezë (shtator 1944), beteja për çlirimin e Tiranës (tetor-nëntor 1944).

Brigada ka zhvilluar një punë të dendur për sqarimin e popullit dhe mobilizimin e masave popullore në luftën kundër fashizmit. Ajo ka zhvilluar biseda e konferenca me popullin, ka ndihmuar në ngritjen e qindra këshillave nacionalçlirimtare të fshatrave e të krahinave, të dhjetëra komandave të vendit. Ka shkëmbyer përvojën e vet me shtabet e qarqeve, të njëjsteve e reparteve partizane dhe të terrenit. Në radhët e brigadës janë përgatitur disa qindra kadro, komandantë e komisarë, nga radhët e luftëtarëve të thjeshtë. Në brigadë kanë mësuar shkrim e këndim 700 luftëtarë. Në përlëshjet e ashpra me pushtuesit italianë, e sidomos gjermanë, si edhe me tradhtarët, dhanë jetën rreth 370 luftëtarë të brigadës. Nga këta kishte komandantë batalioni Gjok Doçi, Xheladin Beqiri (Karadaku), Fejzi Micoli (Vullneti), Tercilio Kardinali; komisar batalioni Myslim Shyri; pesë luftëtarë Inajete (Nete) Dumi, Pinellopi Piro, Flora (Lola) Myteveliu, Agllai Tako, Afërdita Thanasi. Një rol veçanërisht të shquar në plotësimin më nder të detyrës fisnike nga ana e brigadës ka luajtur Mehmet Shehu, komandant dhe Tuk Jakova, komisar.

Garancia e suksesit në luftime, mbështetja e popullit

Ngado që shkonte, kur sulmonte ose kur mbrohej, ajo i kishte kurdoherë shpatullat të sigurta. Masat e gjera popullore e prisnin dhe e përcillnin atë me dashuri. Njerëzit e popullit ia lehtësonin



asaj shumë kryerjen e detyrave duke e ndihmuar me njoftime rreth armikut, duke i treguar udhët e shtigjet, duke e furnizuar me ushqime e, më në fund, edhe duke marrë pjesë tok me të në luftën me armë. Mbështetja e shëndoshë e popullit u jepte vazhdimisht krahë e zemër partizanëve, ua shtonte forcat dhe bindjen në drejtësinë e çështjes për të cilën derdhnin gjak. Se sa vendimtare ishte kjo mbështetje për sigurimin e fitores mbi armiqtë, luftëtarët e brigadës e kishin provuar, e kishin ndierë dhe e kishin prekur në çdo luftim që zhvillonin, në çdo lëvizje që kryenin nga njëra zonë në tjetrën. E kishin provuar edhe në ato raste të rralla kur, për shkak të mashtimit nga tradhtarët, një fshat a një krahinë nuk u jepte atë mbështetje të plotë të zakonshme që gjenin në fshatrat e krahinat e tjera të vendit.

Pathyeshmëria e brigadës, morali i lartë i luftëtarëve

Çdo kuadër e çdo partizan nuk e kishte për gjë vdekjen për lirinë e për atdheun. Si komandanti e komisar, ashtu edhe luftëtari i thjeshtë ishte gati të përballonte çdo vështirësi e çdo pengesë, të bënte çdo therori për të zbatuar urdhrin e Komandantit të Përgjithshëm, të komandës së brigadës ose të komandës së batalionit e të kompanisë. Në çdo rast, në çdo përpjekje, partizanët

kishin një epërsi të pakrahasueshme morale ndaj armiqtë. Kjo forcë morale e pakufishme i kishte themelet në ndërgjegjen e lartë të luftëtarëve. Figurën morale të luftëtarëve të brigadës e ngrinte edhe më lart disiplina e ndërgjegjshme ushtarake. Kjo disiplinë kishte një përmbajtje të shëndoshë revolucionare. Ajo qëndronte kryesisht në zbatimin e urdhrave me përpikëri dhe pa marrë parasysh asnjë rrezik e asnjë pengesë, në plotësimin e të gjitha normave të moralit partizan, të të gjitha rregullave të organizimit të jetës në repartet dhe njësitë e Ushtrisë Nacionalçlirimtare.

Vendosmëria e kuadrove dhe e luftëtarëve

Komanda e brigadës ishte bërë shembull për gjithë komandat e batalioneve e të kompanive. Nuk gjen urdhrë apo vendim të komandës së brigadës që të ketë dështuar; për shkak të përcipërisë ose të mungesës së objektivitetit. Kjo ishte arsyeja e besimit të madh që kishte fituar ajo te komandat varëse dhe te partizanët. Por më e rëndësishmja është se komanda e brigadës dhe, në shembull të saj, komandat e batalioneve, për të përmbushur vendimet e marra, luftonin me këmbëngulje dhe me besim për arritjen e qëllimit. Këmbëngulja për t'ia arritur qëllimit kishte krijuar një mendim të përgjithshëm



se po të fillohej një veprim luftarak, do të çohet patjetër deri në fund. Por në çdo rast sigurohej që veprimi luftarak i filluar, pavarësisht nga zbatimi i këtij ose i atij varianti, të përbënte një fitore. Kështu, pothuaj çdo luftim i brigadës, në sulm a në mbrojtje, ka qenë, në një mënyrë ose në një tjetër, një fitore e vërtetë edhe kur është asgjësuar armiku, edhe kur nuk është asgjësuar, edhe kur është marrë objekti i caktuar edhe kur nuk është marrë.

Karakterit i pandërprerë i luftimeve

S'kishte batalion e kompani që të qëndronte më tepër se 3-4 ditë, shumëshumë një javë, pa luftë. Mesatarisht i bie që brigada të ketë kryer një luftim në çdo dy ditë e gjysmë. Në brigadë lufta e pandërprerë kishte hyrë në gjak të çdo drejtuesi e të çdo partizani, ishte bërë shprehje e çdo luftëtari dhe natyrë më vete e gjithë njësisë. Të ndenjurit gjatë në një vend pa luftuar quhej një gjë pa kuptim. Ndër batalionet e kompanitë merrej si një fyerje në qoftë se një prej tyre ngarkohej më pak se të tjerët të kryente aksione luftarake. Shpesh dëgjohehin ankime pse njëri ose tjetri batalion caktohej në pararojë gjatë marshimit ose në drejtimin kryesor gjatë luftimit. Luftimet e pandërprera përbënin mjetin më të mirë për të mbajtur lart moralin e luftëtarëve, për kalitjen e tyre revolucionare, për të rrënjësuar shpirtin luftarak sulmues, për të forcuar ndjenjën e iniciativës dhe besimin në forcat e veta, për të rritur kadro të shëndoshë ushtarake e politikë.

Tipari kryesor, sulmi dhe shpirti sulmues

Duke ju hedhur një sy luftimeve të njëpasnjëshme të saj, shohim se gati të gjitha janë sulme e kundërsulme mbi armikun. Edhe kur batalionet e kompanitë ishin të detyruara të mbroheshin nga pozicionet, kjo mbrojtje ishte shumë aktive. Kur flitej për luftë në radhët e njësisë, kjo kuptohej si një sinonim i sulmit. Ngjallja dhe rrënjësja e shpirtit sulmues ndër luftëtarët ishte një çështje në të cilën përqendrohej vëmendja më e madhe nga ana e komandave. Karakteri sulmues i luftimeve nuk përjashtonte mbrojtjen. Brigada ka qenë detyruar shpesh të mbrohet, sidomos gjatë operacioneve të armikut. Por kjo mbrojtje asnjëherë nuk ka qenë mbrojtje pozicionesh. Ajo ka qenë një

mbrojtje me kundërsulme të shpeshta, shumica e të cilave kryhej në befasi dhe kthehej në një kurth për kundërshtarin në mësymje. Edhe në ndonjë rast, kur forca të brigadës janë goditur në befasi, sulmi i armikut është pasuar nga kundërsulmi. Çdo pritë e çdo sulm i kundërshtarit, sado i rrezikshëm, është shkatërruar me kundërsulm të rrufeshëm. Karakteri sulmues i pothuaj gjithë luftimeve të brigadës bënte që ajo të mos ishte një objekt i lehtë për t'u goditur nga kundërshtari. Sulmi, si lloji kryesor i luftimit, i jepte mundësi njësisë të sigurote shpesh asgjësimin e armikut e shpartallimin e tij.

Befasia e veprimit

Në të vërtetë më tepër se çdo gjëje tjetër armiqtë i trembeshin befasisë që përdornin partizanët në goditjet e tyre. Terreni malor, lëvizshmëria e madhe, mbështetja e popullit i jepnin njësisë mundësi të pakufizuara për të kryer veprime luftarake të befasishme. Ajo ishte bërë mjeshtre për të shfrytëzuar befasinë në goditjet e saj. Shumica e veprimeve luftarake të brigadës janë zhvilluar në befasi. Befasia përdorej jo vetëm në goditjet me skuadra e kompani, por edhe me batalione e shpesh me forcat kryesore të brigadës. Në të gjitha rastet kur është arritur të ruhet befasia deri në plasjen e pushkës së parë, është siguruar sukses i plotë. Brigada nuk e përdorte befasinë vetëm në veprimet luftarake sulmuese, por dhe në veprimet mbrojtëse. Madje befasia ishte arma më e mirë në duart e batalioneve e të kompanive, arma më frytdhënëse për t'u mbrojtur me sukses gjatë operacioneve armike dhe për të bërë që këto operacione të dështonin. Gjatë operacioneve të tij, zakonisht kundërshtari e dinte që kishte të bënte me Br. I S, por nuk e dinte asnjëherë me saktësi me sa forca të saj kishte të bënte dhe në ç' vend pikërisht do të ndeshet. Pikat ku janë zhvilluar kundërsulmet e befasishme të brigadës gjatë operacioneve të dimrit e të qershorit kanë qenë vende ku armiqtë pak dyshonin se do të goditeshin. Duke shfrytëzuar në kullm befasinë në sulmet dhe kundërsulmet e saj, brigada kishte kujdes të madh që të mos binte vetë nën goditjet e befasishme të kundërshtarit, i cili mund ta përdorte njësoj me sukses këtë armë të rëndësishme. Ajo është goditur vetëm tri herë në befasi, në Çerenec (korrik 1944), në Peshkopi (korrik 1944) dhe në Kelmend (janar 1945). Në rastin e parë sulmi i befasishëm armik, pas kundërsulmit partizan, përfundoi me shpartallimin e xhandarëve dhe të nazistëve, kurse në dy rastet e tjera, batalionet pësuan humbje të ndjeshme, por megjithatë nuk u asgjësuan.

Sigurimi i befasisë varej nga një varg elementësh nga ruajtja e fshehtësisë së rreptë mbi forcat tona, mbi lëvizjen e qëllimin e tyre, mbi vendimet dhe urdhrat e luftimit, nga masat e forta të sigurimit, si gjatë ndenjes në bazë ose në fushim, ashtu edhe në lëvizje, nga shpejtësia në lëvizjet, nga shfrytëzimi sa më i plotë i terrenit nga vigjilencia e lartë e luftëtarëve etj. Përvoja e pasur e Br. I S, është burim studimi për të nxjerrë mësim të vlefshme për përpunimin e shkencës dhe të artit ushtarak shqiptar, përvojë e pasur që gjithmonë duhet trajtuar me vëmendjen më të madhe nga ushtarakët dhe pjesëtarët e FA.

Raporti i zhdrejtë i fuqisë së "shpirtit" me "shpatën" në ushtrinë Afgane

Kolonel HYSNI GJERGJI
Instituti i Kërkimit Shkencor
Ushtarak, AFA

Rënia e shpejtë e Afganistanit në duart e talebanëve, e ktheu këtë vend në pikën "zero" atje ku ndodhej para 20 vitesh, megjithëse perëndimi dhe veçanërisht SHBA shpenzuan triliarda dollarë për të ngritur, trajnuar dhe pajisur ushtrinë dhe forcat e sigurisë afgane, përsëri afganët "humbën luftën pa betejë". Analistët e sigurisë përipiqen të shpjegojnë këtë "shkërmoqje" të ushtrisë afgane duke analizuar parimet dhe përvijën e luftërave në shekuj. Studiues ushtarakë, duke konsideruar raportin e forcave përballë (rreth 1 me 4) në favor të forcave të sigurisë afgane. Talebanët duke qenë në mësymje dhe ushtria afgane e pozicionuar në mbrojtje, vlerësohet të jetë e paprecedentë një humbje e tillë. Historia e luftërave nuk e njeh këtë rezultat të arritur në shekuj, pasi parimi i luftimit tradicional pranon të kundërtën e këtij raporti forcash. Po të shtojmë këtu armatimin dhe pajisjet në dispozicion të palëve, ku ushtria afgane ishte e pajisur me tanke dhe forcë ajrore, infrastrukturë mbrojtëse, fortifikime etj., ky raport është më i thellë.

Rezultati i humbjes së një ushtrie 4 herë më të madhe se sa kundërshtari, në operacion mbrojtës, bëhet akoma edhe më unik për t'u studiuar në historinë e luftërave dhe konflikteve botërore.

Por çfarë mungoi dhe nuk funksionoi tek forcat e sigurisë afgane? Analistët e sigurisë e gjejnë shpjegimin e këtij kapitullimi tek parimet e luftës, ndër të cilat përgatitja dhe gjendja moralopsikologjike e trupave ushtarake në këtë përballje, mori rol kryesor. Çdo armë sado e fuqishme në duart e luftëtarëve pa motiv, pa zemër dhe që nuk duan të luftojnë, historikisht nuk ka pasur vlerë.

Shpirti dhe shpata janë dy faktorët bazë të fuqisë së një ushtrie dhe raporti mes tyre duhet të jetë si 3 me 1 në favor të shpirtit" -na mëson Napolon Bonaparte. Në të vërtetë ky raport i "shpirtit me shpatën", është në sens të kundërt tek përballja e talebanëve me ushtrinë afgane. Fuqia ushtarake e forcave të sigurisë afgane, rezultoi të jetë asgjë pa fuqinë e shpirtit të sakrificës, të ndjenjës së fitores dhe të vetëmohimit të ushtarëve të saj.

Mohammad Shafiq Hamdam, një ekspert i sigurisë në Afganistan thotë për Deutsche Veile se: "Ushtria afgane, të cilën unë e njoh shumë mirë, ishte e demoralizuar gjatë dhe para fillimit të tërheqjes së NATO-s, ndërsa e kundërta ndodhi tek talebanët të cilët qëndronin të motivuar gjatë gjithë kohës dhe morën zemër pas fillimit të tërheqjes së NATO-s. Ushtria afgane mbeti një ushtri në letër, e pa provuar të qëndrojë mbi këmbët e veta, kur të mos mbështetej nga NATO. Mungesa e moralit, e besimit në fitore, e besimit tek liderhipi, vlerësohen të jenë faktorët e rënies së sigurisë së Afganistanit".

Megjithëse NATO dhe SHBA-të shpenzuan biliona për të trajnuar edhe pajisur ushtrinë afgane dhe policinë lokale, përsëri nuk rezultoi mjaftueshëm. U ngrit, u trajnuar dhe u pajis një ushtri me numër dhe pajisje luftarake të krahasueshme me vende të zhvilluara të NATO-s. SHBA-të dhanë gjithçka mund të jepnin pa kursim, por ata nuk mund të jepnin atë që është e brendshme, atë që nuk është e mundur të jepet, atë që ndodhet brenda qenies së secilit: "shpirti i luftës". Kjo nuk është e mundur të transferohet nga njëri tek tjetri nëpërmes faktorëve të jashtëm. Ky komponent i rëndësishëm i luftës



mungoi tek trupat afgane pa moral të lartë luftarak, pa besim dhe pa dëshirë për të fituar këtë luftë.

"Fitimtarët e fitojnë luftën pastaj e fillojnë atë", - na mëson Sun Tzu. Ushtria afgane nuk është ndjerë kurrë si fituese, ka qenë e pamotivuar, nuk ka funksionuar vetë, por gjithmonë parazite dhe e mbajtur në këmbë nga NATO dhe SHBA dhe ka hyrë në këtë luftë "e bindur në humbje". E kundërta ka ndodhur me talebanët, -vlerësojnë ekspertët e sigurisë, -ata kanë luftuar pa ndërprerje me të gjitha metodat, politike dhe brutale, psikologjike dhe terroriste, fetare dhe mizore, duke mbetur kështu faktor edhe pas 20 vitesh nga dëbimi i tyre nga pushteti. Analistët e instituteve të sigurisë vlerësojnë se përveç mungesës së moralit edhe korrupsioni në sigurinë kombëtare afgane ishte shkak kryesor i kolapsit të saj. Korrupsioni vlerësohet të jetë tjetër faktor përcaktues në humbje, pasi në Ministrinë e Mbrojtjes ashtu edhe në ministrinë e brendshme ishte shumë i përhapur, ku fondet, armatimi, municioni dhe ushqimi i ushtarëve vidhej. Furnizimet, para se të shkonin tek ushtarët afganë shiteshin në tregun e zi dhe si rrjedhim shkonin edhe tek talebanët. Në këtë kontekst korrupsioni jo vetëm ka dëmtuar moralin në ushtrinë afgane, por edhe ka ushqyer talebanët me para, ushqime dhe armatime.

Beteja "pa luftë" për të marrë Kabul, nuk ndeshi në kundërpërgjigje nga ana e forcave afgane, pasi shumica e trupave u dorëzuan, dezertuan, u shitën, u blenë apo iu bashkuan talebanëve. Ata nuk iu bashkuan një rezistence, pasi afganët e vlerësonin veten të pa shpresë për

ta fituar këtë luftë dhe nuk kishin besim në liderhipin e tyre, i cili do të mund t'i çonte drejt fitores.

Integriteti i liderhipit drejtues politik dhe ushtarak është thelbësor për të fituar respektin, besimin dhe besnikërinë e trupave. Për ushtarët e papaguar, jeta e gjnjeshtert e drejtuesve nuk pranohej dhe nuk garantonte liderhip të sigurt. Për këtë arsye, shumë ushtarë nuk preferuan të luftojnë, por të shpëtojnë jetën, t'i dorëzohen talebanëve ose të besojnë në një amnisti të premtuar. Përvetësimi dhe korrupsioni minoi dhe përçau lidhjen morale dhe kohezionin brenda hierarkisë ushtarake. Për më tepër disa drejtues ushtarakë jo vetëm vidhnin paratë e "ushtrisë fantazmë me rreth 100,000 vetë", por edhe mbanin ushtarë të papaguar në detyrë, duke mos u dhënë as lejet për të shkuar në familjet e tyre për muaj me radhë. Ushtria afgane përveç sa më sipër, vitet e fundit, pati një numër gjithnjë në rritje të dezertimeve dhe dëmtimeve.

Disa OJQ dhe grupe studiuesish kanë raportuar në mënyrë të përsëritur për korrupsion në ushtrinë afgane dhe qeverinë e Ashraf Ghani's. Sipas "The Washington Post" nga 352,000 që duhet të ishin forcat afgane, vetëm 254,000 mundet të konfirmoheshin nga drejtuesit ushtarakë.

Sipas "The Guardian", në një raport që monitoron shpenzimet në konflikte, thuhet se korrupsioni i pamundur për t'u ndalur, u bë "infektues" dhe demoralizues për trupat e sigurisë. Ushtarët nuk i shikonin liderët e tyre si udhëheqës, por si njerëz pa ideal, me vese dhe tradhtarë.

Ideologjia rreth së cilës duhet të bashkoheshin nuk funksionoi tek afganët. Ata nuk ishin besnikë të Atdeut të tyre

dhe të qeverisë qendrore, por ishin më shumë besnikë të fisit apo besimit fetar. Afganët nuk e shikonin atdeun si më të rëndësishmin në idealet e tyre, por besimin tek feja madje tek sekti brenda fesë së tyre. Nga ana e tyre talebanët ishin të qartë dhe të bashkuar rreth ideologjisë islame qysh nga 2001 dhe asnjëherë nuk kanë reshtur propagandën e ideologjisë së tyre, për dëbim të pushtuesve nga atdeu i tyre.

Talebanët kurrë nuk u larguan nga përfitimi i fondeve për mbijetesën e tyre. Këto burime nuk u goditën apo ndërprejnë asnjëherë nga policia afgane, çka e mbajti gjallë lëvizjen dhe ideologjinë talebane, si dhe vetë ekzistencën e tyre. Sipas Mullah Yaqoob, djali i udhëheqësit të ndjerë shpirtëror të talebanëve, Mullah Mohammad Omar, talebanët fituan 1.6 miliardë dollarë amerikanë gjatë 2020 nga: droga - 416 milionë dollarë me rreth 84% të prodhimit global të opiumit; minierat - 400 milionë dollarë deri në 464 milionë dollarë; minierat e hekurit, mermerit, bakrit, arit, zinkut dhe metaleve të tjera dhe mineraleve të rralla; nga gjomat dhe taksat - 160 milionë dollarë; donacione bamirësie - 240 milionë dollarë; eksportet - 240 milionë dollarë; pasuritë e paluajtshme - 80 milionë dollarë, etj. Në këtë buxhet të konsiderueshëm talebanët, kishin në listëpagesat e tyre edhe një numër të konsiderueshëm të drejtuesve të sigurisë, të infiltëruesve nga të cilët merrnin inteligjencë, por edhe i përdorën në sulmin e tyre final, për të mundur pa luftë një ushtri 4 herë më të madhe në numër.

Kohezioni mes ushtarakëve dhe sensi i detyrës, betimit dhe sakrificës ndaj atdeut mungonte, duke rritur mosbesimin në liderhip, i cili shkante deri në presidencën afgane. Kishte edhe teori konspirative në mes ushtarëve të përhapura me qëllim, që paralajmëronin një marrëveshje të fshehtë midis talebanëve dhe qeverisë afgane. Këto metoda të luftës psikologjike, të përhapura nga talebanët e çorientuan, përçanë dhe goditën përfundimisht kohezionin mes forcave të sigurisë afgane. Ata u demoralizuan deri në pikën e dorëzimit pa armë të të gjithë vendit. Ky mjedis i mosbesimit dhe dëshimit në radhët e ushtarakëve shkante në të kundërtën e talebanëve të cilët ishin të përkushtuar, të vendosur dhe të motivuar për krijimin e Emiratit Islamik.

Interferimi politik dhe lëvizjet e fundit në ndryshimin e drejtuesve ushtarakë dhe të policisë në ditët e fundit, mendohet të jenë faktorët shtesë në dobësimin e performancës së ushtrisë dhe sigurisë afgane. Para tërheqjes së NATO-s u ndryshuan pa motiv Shefi i Shtabit të ushtrisë afgane, gjeneraljettënant Wali Mohammad Ahmadzai, i cili ishte emëruar në Qershor, me gjeneral major Haibatullah Alizai. U zëvendësua ministri i brendshëm dy herë si dhe u bë riorganizim i forcave të sigurisë dukë ndryshuar gjashtë komandantët kryesorë të ushtrisë afgane, brenda tre muajve të fundit. Arratisja jashtë vendit i komandantit të përgjithshëm dhe dorëzimi i shumë gjeneralëve të lartë, ishte pika

kulmore e cila vrau çdo shpresë për rezistencë. Kjo situatë ishte çfarë talebanët e përdorën si pretekst për "bisedime" për "ndryshim paqësor të pushtetit", dhe marrjen e drejtimit të vendit në kushtet kur komandanti i përgjithshëm është arratisur nga Afganistani.

Talebanët nga ana e tyre ndoqën edhe një strategji tjetër "të zgjuar" fill pas fillimit të tërheqjes së NATO-s. Ata morën nën kontroll pikat e kalimit kufitar, rrugët kryesore, si dhe izoluan Kabul nga qytetet e tjera, me qëllim pamundësimin e ndihmës e izolimin nga qeveria qendrore. Shumë reparte të ushtrisë u shkëputën nga qendra dhe u detyruan me forcë ose të arratisen jashtë vendit ose të dezertojnë ose të praninin të vriteshin.

Shpejtësia e rimarrjes së kontrollit të Afganistanit nga Talebanët, ka dalë disi edhe jashtë vlerësimeve të inteligjencës amerikane dhe të NATO-s, të cilët parashikonin nga disa javë deri në disa muaj, marrjen e kontrollit të vendit nga ky grup, pasi nuk pritej arratisja e presidentit, komandantit të përgjithshëm, Ghani. Si rezultat i kësaj "surprize" shumë të huaj janë akoma edhe sot të pa evakuuar për në vendet e tyre, pasi nuk kanë menduar asnjëherë se kjo që po ndodh kaq shpejt, do të ishte e mundur. Lisa Maddox, një ish analiste e CIA-s shkruan: "Nuk është i papritur rezultati i fitores së talebanëve, pasi ata kanë treguar aftësinë e tyre, për t'u ngritur nga humbjet që kanë pësuar, shtu këtu edhe popullsinë e lodhur, varfëruar dhe demoralizuar nga konflikti i tejzgjatur, dhe që ka humbur durimin, besimin dhe shpresën për ndryshim të jetesës së tyre, nga qeveria e fundit afgane sot në arrati. Kështu populli i tradhtuar nga liderhipi, bëhet i gatshëm të ripanojë këtë regjim".

Edhe pse nga SHBA-të u shpenzuan jetë njerëzore, kohë dhe para të panumërta për të rindërtuar sigurinë zyrtare shtetërore në Afganistan, pati vetëm një përpjekje rezistence midis tre luftëtarëve të mirënjohur fisnorë: Atta Muhammad Noor of Jamiat-e-Islami, Abdul Rashid Dostum of Hezb-e-Junbish dhe Haji Muhammad Muhaqiq of Hezbe-e, të cilët u përpoqën në Mazar i Sharif të bashkojnë forcat me ushtrinë afgane për një front të vetëm kundër talebanëve. Edhe kjo rezistencë u theye me rënien e Mazar i Shafiq, dhe këta luftëtarë u detyruan të arratisen jashtë Afganistanit. Rënia e ushtrisë dhe sigurisë afgane, madje edhe para largimit të trupave amerikane dhe të NATO-s, u bë më e rëndë dhe më komplekse nga lirimi i disa mijëra luftëtarëve të "Al Qaida"-s dhe grupeve të tjera terroriste, që mbaheshin të burgosur në bazën ajrore të Bagramit. Ky zhvillim, bashkë me ndërhyrjen, njohjen dhe mbështetjen ndaj talebanëve të disa shteteve të tjera në Afganistan, ditët e fundit vlerësohet se do të sjellë zhvillime, pasoja dhe sfida të tjera të paparashikuara në Afganistan dhe gjeopolitikën përreth dhe përtej tij.

Takimi i G7 mbi Afganistanin

Stoltenberg: Të mbahet hapur aeroporti i Kabulit, parësor evakuimi i njerëzve

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg mori pjesë në samitin virtual të Grupit të Shtatë (G7) mbi Afganistanin të martën (24 gusht 2021). Ai theksoi rëndësinë e mbajtjes të hapur të aeroportit të Kabulit, në mënyrë që të vazhdojnë evakuimet. Stoltenberg tha se disa qindra staf dhe kontraktorë të NATO-s kanë ofruar shërbime kritike, të tilla si kontrolli i trafikut ajror, furnizimi me karburant dhe komunikimet në aeroport. Ai shtoi se NATO ka marrë gjithashtu një rol koordinues për të siguruar që njerëzit të mund të evakohen në mënyrë sa më efektive të jetë e mundur.

Stoltenberg tha se ishte e rëndësishme që të ruheshin fitimet e fituara nga populli afgan në 20 vitet e fundit me mbështetjen e konsiderueshme të të gjithë bashkësisë ndërkombëtare. Ai kujtoi se përparësia kryesore e NATO-s ishte të sigurohej që Afganistani të mos shërbejë përsëri si një platformë për terroristët ndërkombëtarë për të sulmuar vendet tona. Ai theksoi se Al Qaeda është e degraduar dhe nuk ka pasur asnjë sulm terrorist ndaj aleatëve të NATO-s të organizuar nga Afganistani që nga 11 shtatori. Duke pranuar se kërcënimi terrorist mund të rishfaqet, Stoltenberg tha se aleatët e NATO-s do të vazhdojnë të luftojnë terrorizmin ndërkombëtar dhe të sigurojnë që Afganistani të mos bëhet përsëri një strehë e sigurt për grupet terroriste.



Situata në Afganistan

Deklarata e Ministrave të Jashtëm të NATO -s për Afganistanin, Bruksel, 20 gusht 2021

Ministrat e Punëve të Jashtme të NATO-s, mbajtën në Bruksel, një takim të jashtëzakonshëm lidhur me situatën e vështirë në Afganistan. Takimi u mbajt në 20 gusht 2021, përmes video-konferencës, ku ata theksuan shqetësimin e thellë për ngjarjet e rënda në Afganistan dhe bënë thirrje për ndalimin e menjëhershëm të dhunës. Në deklaratën e përbashkët ministrat nëvizojnë se “Detyra jonë e menjëhershme tani është të përmbushim angazhimet tona për të vazhduar evakuimin e sigurt të qytetarëve tanë, shtetasve të vendeve partnere dhe afganëve në rrezik, veçanërisht atyre që kanë ndihmuar përpjekjet tona, shkruhet në deklaratë.

“1. Ne, Ministrat e Jashtëm të NATO -s, u takuam sot për të diskutuar situatën e vështirë në Afganistan.

2. Ne jemi të bashkuar në shqetësimin tonë të thellë për ngjarjet e rënda në Afganistan dhe bëjmë thirrje për ndalimin e menjëhershëm të dhunës. Ne gjithashtu shprehim shqetësim të thella për raportet e shkeljeve dhe abuzimeve serioze të të drejtave të njeriut në të gjithë Afganistanin. Ne pohojmë angazhimin tonë ndaj deklaratës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së më 16 gusht dhe bëjmë thirrje për respektimin e normave dhe standardeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut dhe të drejtën ndërkombëtare humanitare në të gjitha rrethanat.

3. Detyra jonë e menjëhershme tani është të përmbushim angazhimet tona për të vazhduar evakuimin e sigurt të qytetarëve tanë, shtetasve të vendeve partnere dhe afganëve në rrezik, veçanërisht atyre që kanë ndihmuar përpjekjet tona. Ne u bëjmë thirrje atyre që kanë autoritet në Afganistan të respektojnë dhe lehtësojnë largimin e tyre të sigurt dhe të rregullt, përfshirë përmes Aeroportit Ndërkombëtar Hamid Karzai në Kabul. Për sa kohë që operacionet e evakuimit vazhdojnë, ne do të ruajmë koordinimin tonë të ngushtë operacional përmes mjeteve ushtarake aleate në Aeroportin Ndërkombëtar Hamid Karzai.

4. Populli afgan meriton të jetojë në siguri, dinjitet dhe të ndërtojë mbi arritjet e rëndësishme politike, ekonomike dhe sociale që kanë bërë gjatë njëzet viteve të fundit. Ne qëndrojmë pranë aktorëve të shoqërisë civile të cilët duhet të jenë në gjendje të vazhdojnë të luajnë në mënyrë të sigurtë rolin e tyre domethënës në shoqërinë afgane. Ne u bëjmë thirrje të gjitha palëve në Afganistan të punojnë me mirëbesim për të krijuar një qeveri përfshirëse dhe përfaqësuese, përfshirë edhe me pjesëmarrjen kuptimplote të grave dhe grupeve të pakicave. Në rrethanat aktuale, NATO ka pezulluar çdo mbështetje për autoritetet afgane. Çdo qeveri e ardhshme afgane duhet t'i përmbahet detyrimeve ndërkombëtare të Afganistanit; mbrojtjen e të drejtave njerëzore të të gjithë afganëve, veçanërisht grave, fëmijëve dhe pakicave; mbështesin sundimin e ligjit; lejojnë qasje të papenguar humanitare; dhe të sigurohet që Afganistani të mos shërbejë më kurrë si një strehë e sigurt për terroristët.

5. Për njëzet vitet e fundit, ne u kemi mohuar me sukses terroristëve një strehë të sigurt në Afganistan nga e cila mund të nxisin sulme. Ne nuk do të lejojmë që asnjë terrorist të na kërcënojë. Ne mbetemi të përkushtuar për të luftuar terrorizmin me vendosmëri dhe solidaritet.

6. Ne nderojmë shërbimin dhe sakrificën e të gjithë atyre që kanë punuar pa u lodhur gjatë njëzet viteve të fundit për të realizuar një të ardhme më të mirë për Afganistanin. Së bashku, ne do të reflektojmë plotësisht mbi angazhimin tonë në Afganistan dhe do të nxjerrim mësimet e nevojshme. Ne do të vazhdojmë të promovojmë Afganistanin e qëndrueshëm, të begatë që populli afgan meriton dhe të adresojmë pyetjet kritike me të cilat përballet Afganistani dhe rajoni, në të ardhmen e afërt dhe më gjerë, përfshirë përmes bashkëpunimit tonë me partnerët rajonalë dhe ndërkombëtarë, si Bashkimi Evropian dhe Kombet e Bashkuara.”

“Të luftosh për atë që beson nuk është kurrë e kotë”

Komiteti Ushtarak i NATO -s thirri takim të veçantë me partnerët e misionit RSM

Më 19 gusht 2021, Komiteti Ushtarak i NATO -s thirri një takim të veçantë me partnerët e tij të misionit mbështetës të vendosur për të diskutuar situatën e vazhdueshme në Afganistan dhe koordinimin e vazhdueshëm të qasjes së tyre të përbashkët.

Në këtë takim të jashtëzakonshëm, përfaqësuesit Ushtarakë të NATO-s u takuan me homologët e tyre që përfaqësonin Partnerët Operacionalë të Mbështetjes Vendosëse, (Armenia, Australia, Austria, Azerbajxhani, Bosnje-Hercegovina, Finlanda, Gjeorgjia, Mongolia, Zelanda e Re, Suedia dhe Ukraina), për të diskutuar situatën e vazhdueshme në Afganistan, qasjen e tyre të përbashkët dhe evakuimin e vazhdueshëm të stafit të lidhur me NATO-n.

Që nga rënia e vendit, NATO dhe aleatët kanë punuar gjatë gjithë kohës për të mbajtur operacionet në aeroportin ndërkombëtar të Kabulit dhe për të mundësuar që personeli i NATO -s, Aleatëve, Partnerëve dhe anëtarëve të tij të evakohen në mënyrë të sigurt. NATO dhe Kombet tani janë duke punuar në koordinimin e qasjes së tyre të përbashkët në përgjigje të këtyre ngjarjeve të fundit. Një takim i jashtëzakonshëm ministror i Jashtëm u thirr më 20 gusht 2021, gjithashtu. Pas takimit, Admirali Bauer postoi



një video në mediat sociale në të cilën ai i drejtohet, në emër të Komitetit Ushtarak, të gjitha trupave aleate dhe partnere që kanë shërbyer në misionet e NATO -s në Afganistan.

Teksti i plotë i video-mesazhit të Admirali Bauer mbi misionin në Afganistan, 19 gusht 2021

“Të dashur trupa nga vendet aleate dhe partnere që kanë shërbyer në misionet e NATO -s në Afganistan. Sot në mëngjes, Komiteti Ushtarak i NATO-s u mbledh për të diskutuar situatën aktuale në Afganistan.

Shpejtësia e rënies së forcave dhe qeverisë afgane të sigurisë ka krijuar një debat të nxehtë në Forcat tona të Armatosura dhe shoqëritë tona. Sakrificat tuaja atje e bëjnë këtë një çështje shumë të afërt me zemrat tona. Shumë pyesin: ja vllente? A ishin përpjekjet tona të kota? Përgjigjet e këtyre pyetjeve janë thellësisht personale.

Por, në emër të Komitetit Ushtarak, do të doja t'ju them të gjithëve: se luftimi

për atë që besoni ,nuk është kurrë i kotë. Duke bërë atë që qeveritë tuaja demokratike ju kanë kërkuar të bëni dhe përmbushja e rolit që ishte mishëruar në kushtetutat tona, nuk është kurrë e kotë.

Rreth një milion burra dhe gra tanë me uniformë shërbyen në Afganistan. Duke lënë pas të dashurit e tyre për të ndihmuar në ndërtimin e një të ardhme më të mirë për njerëzit atje.

Vënia e jetës tuaj në shërbim të lirisë ka shumë për të ofruar. Por mund, dhe ka, gjithashtu që çuan në plagë, fizike apo mendore. Ka familje që po përballen me humbje të jashtëzakonshme.

Për ata që janë duke luftuar: ju lutemi kontaktoni një shok ose një organizatë veterane për të marrë ndihmën që ju nevojitet dhe që meritoni shumë.

Të gjithëve ju them: Shërbimi juaj në Afganistan ka ndryshuar në mënyrë të pakthyeshme vendin, ashtu siç ju ka ndryshuar ju në mënyrë të pakthyeshme. Sakrifika individuale që keni bërë nuk duhet marrë kurrë si e mirëqenë.”

Siguria në Detin e Zi, ka një rëndësi të madhe për NATO-n

MSC. MIMOZA GOLIKJA

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO -s Mircea Geoana mbërriti në Kiev, Ukrainë në 23 gusht 2021, për të marrë pjesë në Samitin inaugurues të Platformës së Krimesë. Duke iu drejtuar Samitit, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm theksoi se NATO qëndron me Ukrainën dhe i bëri thirrje Rosisë të kthejë kontrollin e gadishullit të Krimesë në Ukrainë. “Krimea është territori i Ukrainës,” tha ai, duke shtuar se situata e sigurisë në Krime, Ukrainën lindore dhe Detin e Zi dhe Azov ndikon në NATO dhe bashkësinë ndërkombëtare. Zoti Geoana përsëriti mbështetjen e NATO-s për lirinë dhe pavarësinë e të gjithë Ukrainës. Ai nënvizoi gjithashtu mbështetjen e fortë praktike të Aleancës për Ukrainën, duke përfshirë edhe më shumë stërvitje, trajnime dhe financime të përbashkëta. Në një panel të Samitit mbi sigurinë e Detit të Zi, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm theksoi rëndësinë strategjike të Detit të Zi dhe situatën në dhe përreth Ukrainës për NATO-n dhe partnerët e saj. Ai vuri në dukje se Aleanca ka rritur praninë e saj në Detin e Zi që nga aneksimi ilegal dhe i Rusisë i Krimesë.

Në margjinat e Samitit, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm zhvilloi takime dypalëshe me Dmytro Razumkov, Kryetar i Rada Verkhovna të Ukrainës, i bashkuar nga Aleksandr Merezhko dhe Aleksandr Zavitnevych; Oleksiy Danilov, Sekretar i Këshillit Kombëtar të Sigurisë dhe Mbrojtjes; dhe Olha Stefanishnya, Zëvendëskryeministre për Integrimin Euro-Atlantik. Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm falënderoi Ukrainën për kontributin e saj në misionet dhe stërvitjet e NATO -s, si dhe për përpjekjet e saj për të evakuuar jo vetëm qytetarët e saj, por edhe ata të Aleatëve, partnerëve dhe afganëve. Ai gjithashtu përshëndeti përparimin e Ukrainës në realizimin e reformave kryesore dhe inkurajoi qeverinë të vazhdojë kursin, veçanërisht në çështjet e qeverisjes së mbrojtjes, mbikëqyrjes parlamentare dhe transparencës. Ai theksoi se këto reforma janë thelbësore, si për të sjellë Ukrainën më afër NATO -s, por para së gjithash për të ndërtuar sigurinë dhe zhvillimin për të gjithë ukrainasit. Duke përfunduar vizitën e tij në (24 gusht, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm ndoqi festimet për 30 vjetorin e pavarësisë së Ukrainës.

Tema e Krimesë nuk është çështje vetëm e Krimesë

“Presidenti Zelensky përgëzime për ju dhe ekipin tuaj për këtë ngjarje të jashtëzakonshme, është një kënaqësi e vërtetë të jesh pjesë e këtij samiti”, tha në hyrje të fjalës së tij Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Mircea Geoana në Samitin Inaugurues të Platformës së Krimesë. “Ju e keni përshkruar Ukrainën, zoti President, si një komb, dhe unë citoj, “në të njëjtën kohë shekuj dhe të rinj”. Për dikë që vjen nga një demokraci e re, unë e di rëndësinë e kësaj lufte shekullore për liri dhe pavarësi. Populli ukrainas ka zgjedhur rrugën e lirisë, demokracisë dhe integritetit euroatlantik dhe siç tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, zoti Kryetar, para Rada Verkhovna në fjalimin e tij, NATO qëndron fort pranë jush. NATO dënon me forcë dhe nuk do të njohë aneksimin ilegal dhe të paligjshëm të Krimesë nga

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO -s: Krimea është Ukrainë



Rusia.”, tha z. Geoana. “Krimea është territori i Ukrainës dhe ne i bëjmë thirrje Rosisë të kthejë kontrollin e gadishullit në Ukrainë. Situata e sigurisë në Krime, Ukrainën lindore, Detin e Zi dhe Azov na prek të gjithëve. Veprimet e Rosisë kanë sjellë vuajtje dhe humbje të pallogaritshme për popullin ukrainas dhe ato minojnë të drejtën ndërkombëtare dhe kërcënojnë rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla.

Tema e Krimesë nuk është çështje vetëm e Krimesë. Është një çështje për të gjithë ne në botën e lirë demokratike. Në Samitin tonë në qershor, udhëheqësit e NATO-s konfirmuan mbështetjen e tyre të palëkundur për sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës. Ne dënuam aktivitetet ushtarake të Rosisë dhe destabilizimin e saj dhe u bëjmë thirrje atyre të ndalojnë abuzimet dhe shkeljet e të drejtave të njeriut kundër të gjithë ukrainasve, përfshirë tatarët e Krimesë. Përsëritet udhëheqësit e këtij komuniteti të rëndësishëm, për t'i dhënë fund kufizimeve në lirinë e lundrimin në Detin e Zi, përfshirë hyrjen në Detin e Azovit dhe portet e Ukrainës. Ne përsërisim vendimin e Samitit të Bukureshtit që Ukraina dhe Gjeorgjia do të bëhen anëtare të NATO -s. Dhe ne përgëzojmë angazhimin e Ukrainës për një zgjidhje paqësore të konfliktit në Ukrainën lindore. Përpjekjet tuaja për të mbrojtur të drejtat dhe interesat tuaja sovraane, përfshirë aneksimin ilegal dhe të paligjshëm të Krimesë, përmes mjeteve ligjore dhe diplomatike. Kjo Platformë Ndërkombëtare e Krimesë është një shembull i rëndësishëm i kësaj. Ka shumë referenca për sigurinë e Detit të Zi, dhe ky rajon ka një rëndësi të madhe për NATO-n. Tre aleatë të NATO-s janë shtete bregdetare, me forcat e tyre në rajon, Turqia, Bullgaria dhe Rumania. Që nga aneksimi ilegal dhe i paligjshëm i Krimesë nga Rusia në 2014, NATO ka rritur praninë e saj në rajon. Anijet e NATO-s operojnë në mënyrë rutine në Detin e Zi në përputhje me ligjin ndërkombëtar. Ne kemi rritur bashkëpunimin tonë me Gjeorgjinë dhe Ukrainën, me më shumë ushtrime, më shumë vizita në port dhe ndarjen e vetëdijes për situatën.

Vetëm stërvitja e muajit të kaluar ‘Sea Breeze’, e organizuar nga marinat amerikane dhe ukrainase, me më shumë se 30 vende pjesëmarrëse, 32 për të qenë më të saktë, ishte një shembull i rëndësishëm i kësaj. NATO vazhdon të mbështesë përpjekjet e Ukrainës për

të konsoliduar demokracinë, forcuar sundimin e ligjit dhe reformuar sektorët tuaj të sigurisë dhe mbrojtjes. Duke përfshirë mbështetjen për ngritjen e kapaciteteve për forcat e armatosura të Ukrainës, dhe për të trajtuar kërcënimet kibernetike dhe hibride.” Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO -s Mircea Geoana, falenderoi presidentin e Ukrainës “për këtë nismë të rëndësishme”. NATO qëndron pranë popullit ukrainas, tha z. Geoana. “Ne bëjmë thirrje për kthimin e Krimesë dhe në mbështetje të lirinë dhe pavarësinë e të gjithë Ukrainës.”

Marrëdhëniet e NATO-s me Ukrainën

Një Ukrainë sovraane, e pavarur dhe e qëndrueshme, e angazhuar fort për demokracinë dhe sundimin e ligjit, është çelësi për sigurinë euro-atlantike. Marrëdhëniet midis NATO-s dhe Ukrainës datojnë në fillim të viteve 1990 dhe që atëherë janë zhvilluar në një nga partneritetet më thelbësore të NATO-s. Që nga viti 2014, në vazhdim të konfliktit Rusi-Ukrainë, bashkëpunimi është intensifikuar në fushat kritike. Dialogu dhe bashkëpunimi filluan kur Ukraina e sapo pavarur u bashkua me Këshillin e Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut (1991) dhe programin e Partneritetit për Paqe (1994). Marrëdhëniet u forcuan me nënshkrimin e Kartës së 1997 për një Partneritet Dallues, i cili krijoi Komisionin NATO-Ukrainë (NUC) për të çuar përpara bashkëpunimin. Deklarata e vitit 2009 për të plotësuar Kartën NATO-Ukrainë mandatoi NUC, përmes Programit Vjetor Kombëtar të Ukrainës, për të mbështetur përpjekjet e Ukrainës për të çuar përpara reformat që synojnë zbatimin e aspiratave euroatlantike të Ukrainës, në përputhje me vendimet e Samitit të NATO-s në Bukuresht në vitin 2008. Bashkëpunimi është thelluar me kalimin e kohës dhe është reciprokisht i dobishëm me Ukrainën që kontribuon në mënyrë aktive në operacionet dhe misionet e drejtuara nga NATO. Prioritet i jepet mbështetjes për reformën gjithëpërfshirëse në sektorin e sigurisë dhe mbrojtjes, e cila është jetike për zhvillimin demokratik të Ukrainës dhe për forcimin e aftësisë së saj për të mbrojtur veten. Në përgjigje të konfliktit Rusi-Ukrainë, NATO ka përfunduar bashkëpunimin e saj për zhvillimin e aftësive dhe ngritjen e kapaciteteve në Ukrainë. Aleatët dënojnë dhe nuk do të njohin

aneksimin ilegal dhe të paligjshëm të Rosisë të Krimesë, dhe aktivitetet e saj destabilizuese dhe agresive në Ukrainën lindore dhe rajonin e Detit të Zi. NATO ka rritur praninë e saj në Detin e Zi dhe ka rritur bashkëpunimin detar me Ukrainën dhe Gjeorgjinë. Që nga Samiti i NATO-s në Varshavë në korrik 2016, mbështetja praktike e NATO -s për Ukrainën përcaktohet në Paketën e Ndhmës Gjithëpërfshirëse (CAP) për Ukrainën. Në qershor 2017, Parlamenti ukrainas miratoi legjislacionin që rivendos anëtarësimin në NATO si një objektiv strategjik të politikës së jashtme dhe të sigurisë. Në vitin 2019, ndryshimi përkatës i Kushtetutës së Ukrainës hyri në fuqi. Në shtator 2020, Presidenti Volodymyr Zelenskyy miratoi Strategjinë e re të Sigurisë Kombëtare të Ukrainës, e cila parashikon zhvillimin e partneritetit të veçantë me NATO -n me qëllim të anëtarësimin në NATO.

Kuadër për bashkëpunim

